



Datë: 13.01.2026

Numër Protokolli: 154/2026

A.nr.1899/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi Bajraktari, anëtarë, me Kaltrina Avdullahi Prenaj, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1899/2025, të datës 12.11.2025, të parashtruar nga ankuesja, N.M, kundër organit të punësimit: Komuna e Gjilanit, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3, dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 13.01.2026, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa A.nr.1899/2025, e datës 12.11.2025, e parashtruar nga ankuesja, N.M.

II. Mbetet në fuqi Lista me numër të protokollit 02-016-96169/25, e datës 21.10.2025, e Njësisë së Personelit të Komunës së Gjilanit lidhur me shpalljen e kandidatit të suksesshëm në procedurën e rekrutimit me numër reference RN00018482, pozita e punës Zyrtar Administrativ.

A r s y e t i m

Ankuesja, N.M (në *tekstin e mëtejme referuar*: Ankuesja), më datë 12.11.2025, përmes postës elektronike (ankesa.kpmschck@rks-gov.net), ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, lidhur me procedurën e rekrutimit me numër reference RN00018482, Grupi i Administrimit të Përgjithshëm, respektivisht, pozita *Asistent Administrativ*, të shpallur nga Komuna e Gjilanit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në *tekstin e mëtejme referuar*: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Gjilanit, ndërsa kjo e fundit ka përcjellë përgjigjen në ankesë së bashku me provat materiale referuar çështjes ankimore.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 7333/2025, të datës 12.11.2025, të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kopjen e letërnjoftimit të ankueses; Listën përfundimtare të kandidatëve, e datës 21.10.2025; Formularin për parashtrimin e ankesës të datës 12.11.2025; Kërkesën për përgjigje në ankesë, të datës 20.11.2025; Përgjigjen në ankesë të datës 08.12.2025, me të gjitha dokumentet e bashkangjitura nga organi i punësimit; Vendim me numër protokolli Nr.02-016-105577/25, i datës 21.11.2025; Njoftim për test me shkrim, i datës 07.10.2025; Njoftim për verifikim paraprak me numër protokolli Nr.3100, i datës 03.10.2025; Lista e aplikantëve (të aprovuar dhe refuzuar); Vendim për themelimin e Komisionit të Pranimit me numër protokolli Nr.02/1281, i datës 09.09.2025; Akt emërimi me numër Nr.02/016-819/25, i datës 06.01.2025; Akt emërimi me numër AE.Nr.02-016/01-102597/21, i datës 03.09.2021; Vendim me numër protokolli 02-1282, i datës 09.09.2025; Akt emërim me numër protokolli 02-16-20120, i datës 22.07.2011; Akt emërim me numër protokolli Nr.02/1800, i datës 28.10.2024; Ndryshimi dhe plotësimi i aktit të emërimit 02-27537-1, i datës 30.12.2013; Akt emërim me numër protokolli 02-524/187, i datës 15.09.2011; Konkursin me numër reference RN00018482, i datës 21.08.2025; Aprovim dhe konfirmim të Qëndrueshmërisë Buxhetore/Autorizim, i datës 09.01.2025; Aplikacioni me datë aplikimi 05.09.2025, i kandidatës N.A me të gjitha dokumentet e bashkangjitura; Aplikacioni me datë aplikimi 30.08.2025, i ankuese N.M me të gjitha dokumentet e bashkangjitura.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se ankesa është e pabazuar, **sepse:**

Vlerësimi i çështjes

Nga administrimi i provave materiale të çështjes rrjedhë se:

- Komuna e Gjilanit më datë 06.09.2024, ka shpallur konkursin publik me numër reference RN00018482, për Grupin e Administrimit të Përgjithshëm, pozita *Asistent Administrativ në Zyrën e Kryetarit*, me klasë të pozitës profesional 3, një (1) vend i lirë pune, me afat aplikimi nga data 22.08.2025 deri më datë 20.09.2025.

-Në këtë konkurs kishte aplikuar edhe ankuesja dhe së e njëjta përmes Njoftimit me numër protokolli Nr.3100, të datës 03.10.2025, të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Gjilanit ishte përfshirë në listën e kandidatëve që kanë plotësuar kriteret formale të konkursit përkatës, ku të njëjtit më datë 07.10.2025 ishin njoftuar lidhur më kohën dhe vendin e mbajtjes së testit me shkrim, që rezulton të jetë më datë 09.10.2025 në ora 14:00, Objekti i Rilindjes në Prishtinë, Salla Nr.015, mirëpo, që sipas thënieve në ankesë dhe provave tjera të lëndës vërtetohet se ankuesja nuk kishte marr pjesë në fazën e testimit me shkrim.

-Më 21.10.2025, Njësia e Personelit të Komunës së Gjilanit ka publikuar listën për kandidatin e suksesshëm në procedurën e rekrutimit më numër reference RN00018482, e sipas të cilit akt N.A është shpallur si kandidate fituese më gjithsej 86.8 pikë.

Pretendimet ankimore

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin civil të Kosovës pretendon se nuk ka marrë asnjë njoftim zyrtar për kohën dhe vendin e testit me shkrim, nën supozimin se mos njoftimi ka penguar në pjesëmarrjen në testin me shkrim. Me tej, ankuesja shton së kandidatja e përzgjedhur kishte ndryshim të emrit të pozitës, krahasuar me konkursin e shpallur. Kërkon që Këshilli ta vlerësoj ligjshmërinë e kësaj procedure të rekrutimit.

Vlerësimi i Kolegjit

Kolegji i Këshillit mbështetur në mandatin kushtetues dhe ligjor lidhur me sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, e ndërlidhur me nenin 86 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: *“Organi publik përcakton, në mënyrë të pavarur, llojin dhe shtrirjen e shqyrtimit administrativ, si dhe vlerëson nëse një fakt apo rrethanë është e nevojshme për zgjidhjen e çështjes”*, dhe duke qenë së ankuesja ka kundërshtuar edhe aktin përfundimtar lidhur me shpalljen e kandidatit fitues, Kolegji ka analizuar në kuptim të ligjshmërisë veprimet administrative të ndërmarra në procedurën e kontestuar më ankesë, ashtu që, mbi këtë bazë, fillimisht ka analizuar aktin e shpalljes së konkursit në kuptim të vendosjes së drejtë të kriterëve formale dhe themelimin e komisionit të pranimi në pajtim me kërkesat ligjore.

Rrjedhimisht, nga analizimi i aktit të shpalljes së konkursit me numër reference RN00018482, vërtetohet së si kërkesa të përgjithshme formale për pozitën e kontestuar kanë qenë: **Arsimimi i kërkuar:** *Arsim i mesëm i paspecifikuar* **Përvoja e punës e kërkuar:** *nuk kërkohet*, e që në vlerësimin e Kolegjit grupimi i pozitës dhe kriteret formale kanë qenë në pajtim me Rregulloren në (QRK) Nr.06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil.

Ndërsa, sipas Vendimit nr.prot: 1281 të datës 09.09.2025, të Kryetarit të Komunë së Gjilanit, Komisioni i pranimi për vlerësimin profesional të kandidateve në procedurën me numër reference RN00018482, ka qenë në përbërje nga B.K, kryesues, Menaxher i Burimeve Njerëzore, në Komunën e Gjilanit, Q.A, anëtar, udhëheqës i Sektorit të Bibliotekës në Komunën e Gjilanit, F.K, anëtar, Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve Publike në Komunën e Kamenicës, J.A, anëtar, Zyrtar i Arsimit të Mesëm, në Drejtorinë e Arsimit të Komunës së Gjilanit dhe A.M, anëtar, Udhëheqës i Sektorit për Punë Profesionale në Komunën e Artanës.

Ndërsa, në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore, Kolegji i Këshillit iu referuar dispozitave të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, më theks të veçantë:

-Nenit 9: 1. *Kriteret e përgjithshme që një person duhet t'i plotësojë në procedurën e rekrutimit, për t'u pranuar si zyrtar publik në cilëndo kategori apo nivel, janë: 1.1. të jetë shtetasi Republikës së Kosovës; 1.2. të ketë zotësi të plotë veprimi, sipas legjislacionit në fuqi; 1.3. të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët; 1.4. të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse; 1.5. të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje; 1.6. të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik; 1.7. të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkua për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës; dhe 1.8. të kaloj me sukses procedurat*

e pranimi të përcaktuara në këtë ligj. 2.Përfundimisht, për pozita specifike të zyrtares/it publik, mund të kërkojnë kriteret specifike shtesë. Procedura dhe kriteret për plotësimin e përshtatshmërisë dhe/apo të kriterëve specifike shtesë, do të përcaktohet me akt nënligjor të miratuar nga Qeveria, me propozim të ministrisë përgjegjëse për administratë publike.

-Neni 44 :1. Pranimi në pozitë të kategorisë së ulët dhe të mesme drejtuese bëhet me konkurs të hapur dhe publik të organizuar për çdo pozitë të lirë. 2. Procedura e rekrutimit organizohet nga njësia përgjegjëse për institucionet e administratës shtetërore dhe nga NjMBNj për çdo institucion tjetër shtetëror. 3. Shpallja e procedurës së rekrutimit bëhet nga njësia përgjegjëse, në SIMBNj-së, në uebfaqen e institucionit përkatës, si dhe me mjete të tjera të përshtatshme të informimit. 4. Pranimi i aplikacioneve bëhet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e shpalljes së procedurës së rekrutimit. 5. Konkurrimi zhvillohet në dy (2) faza: 5.1. verifikimi paraprak, përmes së cilit verifikohet nëse kandidatet/ët plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të posaçme, sipas shpalljes së konkursit; dhe 5.2. vlerësimi profesional, që përfshin vlerësimin e njohurive, aftësive dhe cilësive profesionale të kandidateve/ëve. 6. Verifikimi paraprak kryhet nga njësia përgjegjëse, ndërsa vlerësimi profesional kryhet nga komisioni i pranimi për pozita të kategorisë së ulët dhe të mesme drejtuese. 7. Vlerësimi profesional i kandidateve/ëve përfshin testim me shkrim në formë elektronike ku sigurohet anonimiteti i konkurrentëve, si dhe intervistë me gojë. 8. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është njëqind (100) pikë.

-Neni 42: 1. Vlerësimi profesional i kandidateve/ëve për pranim në shërbim civil në pozitën e specialistes/it, bëhet nga komisioni i pranimi për kategorinë e specialistes/it. 2. Komisioni i pranimi për kategorinë e specialistes/it ka pesë (5) anëtarë/ë, në këtë përbërje: 2.1. tre (3) nëpunës/ës civil të nivelit të mesëm apo të ulët drejtues të specializuar në fushën përkatëse për pozitën apo grupin e pozitave për të cilat zhvillohet konkurrimi; 2.2. një (1) përfaqësues/e nga njësia përgjegjëse; dhe 2.3. një (1) profesore/r i fushës së njëjtë për pozitën për të cilën zhvillohet konkurrimi.

Kolegji i Këshillit referuar përcaktimit ligjor si me sipër si dhe duke u bazuar në analizimin e provave materiale të çështjes ka konstatuar se në rrethanat e rastit konkret ankueses nuk i është cenuar ndonjë e drejtë apo interes juridik, pasi që nga provat e dorëzuara nga organi i punësimit konstatohet fakti më datë 07.10.2025, Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Gjilanit, kishte njoftuar kandidatët që kanë kaluar verifikimin paraprak lidhur me mbajtjen e testit me shkrim përfshirë këtu edhe ankuesen. Rrjedhimisht, njoftimi për mbajtjen e testit me shkrim ishte dërguar në email adresën e shënuar nga vet ankuesja në aplikacionin e datës 30.08.2025 (n.m@hotmail.com), andaj, mbi këtë rrethana nuk gjen mbështetje pretendimi ankimor i ankuese së e njëjta nuk ka pranuar njoftim zyrtar për mbajtje të testit me shkrim.

Ndërsa, lidhur me përfundimin ankimor se kandidatja e përzgjedhur kishte ndryshim të emrit të pozitës, krahasuar me konkursin e shpallur, Kolegji nga shkresat e lëndës ka gjetur se qëndron fakti se sipas Listës Përfundimtare më nr.prot:02-01-96169125, të datës 21.10.2025, për shpalljen e kandidat fitues është shënuar gabimisht titulli i pozitës, ashtu që, emri i pozitës figuron me emërtimin Zyrtar për Regjistrimin e Pronave të Paluajtshme dhe Informacion Kadastral, mirëpo, sipas shkresës në fjalë ka qenë lehtë e kuptueshme se kemi të bëjmë me gabim teknik pasi që numri i referencës së konkursit ka qenë i saktë, dhe po ashtu vet Njësia e Burimeve Njerëzore të Komunës së Gjilanit, më Vendimin Nr.prot: 02-016-105577/25 të datës 21.11.2025, ka korrigjuar listën përfundimtare nr.prot:02-01-

96169125, të datës 21.10.2025, në atë mënyrë që është korigjuar lëshimi teknik lidhur me titullin e pozitës. Mbi këtë fakt, rrjedhë së një lëshim i tillë teknik nuk përben shkelje ligjore, sepse në asnjë mënyrë nuk ka cenuar të drejtat e kandidatëve në procedurë.

Kolegji në kuptim të parimit të meritokracisë si një parimet bazë për pranim në shërbim civil ka shqyrtuar edhe dosjen e aplikimit të kandidates fituese N.A (dokumentacionin e dorëzuar së bashku me përgjigjen në ankesë) nga dhe ka gjetur, se e njëjta posedon Diplomën e datës 31.02.2005, për përfundimin e shkollës së mesme të përgjithshme në Gjimnazin “ Zenel Hajdini” në Gjilan, andaj, duke qenë së e njëjta në fazën e vlerësimit ka arritur numrin më të madh të pikëve të vlerësimit, atëherë, e konsiderohet edhe si kandidate e suksesshëm për këtë procedurë të pranim, kështu që, mbi këtë bazë, njësia përgjegjëse në këtë rast Njësia e Personelit në Komunën e Gjilanit ka vepruar pajtim më nenin 11 të Rregullores Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, duke e shpallur të njëjtën si kandidate fituese.

Thënë si më lartë, e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 18, paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

A.nr.1899/2025

Kaltrina Avdullahi Prenaj

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj Demi

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses, N.M;
- Komunës së Gjilanit: Kryetarit të Komunës dhe Udhëheqësit të Personelit
- Arkivit të KPMSHCK-së